

# Të jesh vetvetja në çdo situatë!

**Edukimi.** Luani, Tigri, Ariu kanë fuqi të jashtëzakonshme, si kafshë grabitqare, por në cirk, në sajë të edukimit, ato sillen butë dhe pa agresivitet. Për një njeri që rritet në një ambient të edukuar me normat e respektit reciprok, sjellja e mirë është normale, e kundërta ndodh për ata që janë rritur në ambiente të vrazhda, për ta normal është agresiviteti. Sjellja e mirë nuk trashëgohet përmes gjeneve, ajo është rezultat i edukimit dhe premtion kohezion social, ndërsa agresiviteti prodhon shpërndarje, përçarje. Parlamenti është një vend i krijuar nga qytetërimi për të rrahur mendimet me butësi e të punojnë së bashku. Por në vend që të bëjnë kështu parlamentarë në disa vende ballkanike, rreken të imponojnë mendimin e tyre me agresivitet verbal. Por siç e shënuam më lart, kjo mënyrë të vepruari nuk është veti e njeriut të edukuar, madje nuk mund të cilësohet si veti njerëzore.

**Pigmalion** ishte mbreti legjendar i ishullit të Qipros dhe autor i një statuje me të cilën ai ra në dashuri. Mitologjia thotë se Afroditë e solli statujën në jetë. Në ShBA, në vitet '50 një psikolog llogariti koeficientin intelektual të nxënësve (IQ). Për ato që ishin nën mesataren 100, psikologu i paraqiti sikur të ishin mbi 100-të, në të kundërt ata që ishin realisht mbi 100-të, i paraqiti si më të dobët, pra nën 100-të. Në fund të vitit, ai kontrolloi rezultatet dhe vërejtja që ata që kishin qenë më të dobët, çuditërisht ishin tani më të mirët, sepse ishin trajtuar si më të mirët, ndërsa ata që ishin në fakt më të mirët, meqë ishin trajtuar si nxënës të dobët, arritën rezultate mesatare. Kështu lindi efekti pigmalion: shpesh arritet vijë si rezultat i pritjes pozitive nga individët dhe aksionet e këtyre individëve. Në shoqërinë tonë korri i sharjeve dhe i linçimeve publike, sulmet verbale apo shkrimet tendencioze në gazeta, komplotet dhe shpifjet e kolegëve nuk mund të kenë veçse efekt negativ në rezultatet e punëve

**Romani** mendoj është gjinia më e plotë për komoditetin e shprehjes; ai të lejon të shprehësh gjithçka pa asnjë kufizim dhe në të gjitha nivelet e mundshme. Gjithashtu mendoj se letërsia dhe brenda saj romani janë mjetet më të fuqishme dhe më të sofistikuara të transmetimit të ideve, që jo vetëm që i tejkalon format e tjera të shprehjes, si poezinë, prozën e shkurtër dhe publicistikën, por janë, për mendimin tim, mjete edhe shumë më të sofistikuara madje edhe se filozofia. Personalisht, përmes letërsisë e kam zbuluar jetën time, sepse sa here që ndesh një individ meskin, ngatërrestar, (sepse termi komplotist nuk shkon me rangjet e vogla që na bëjnë përditë kryesisht dëshaktët) nuk trishtohem, siç do të ndodhte me një njeri normal, por gëzohem me idenë se e zbulova edhe një personazh për romanet e mi. U them përmes kësaj primitivëve që bëjnë spektakle në parlamentet tona se janë veçse tartufët e ardhshëm të librave të rinj.



**Klara Buda** është gazetare, shkrimtare dhe aktiviste e të drejtave të njeriut. E vendosur në Paris që prej vitit 1990, ajo ka punuar respektivisht për UNESCO-n, BBC-në dhe Radio Francën Internacionale, ku drejtoi redaksinë shqipe deri në mbylljen e saj. Pas studimeve të Letërsisë moderne dhe të krahasuar në Sorbonne, ajo ndryshoi drejtimin e saj fillestar të Mjekësisë Veterinare dhe u diplomua në Histori Arti dhe Metoda të Studimit të Historisë, në Ecole Pratique des Hautes Études, E.P.H.E. në Paris. Ndër botimet e saj veçojmë romanin “Kloroform mbi fatin e individit në totalitarizëm”, vëllimin “Kosova Mon Amour”, e nderuar me çmimin e publicistikës, kritikës dhe të esesë në panairin e librit “Prishtina 2017”, përktimin në frëngjisht të rrëfijës “Fshati im e pi rakinë”, të Mitrush Kutelit, si dhe studimin akademik “Rrëfija Kuteliane”. Romani “Pëshpërimë Gruaje”, botuar nga “MAPO Editions”, është një fiksjon që i vendos ngjarjet në vitet '80 në regjimin totalitar shqiptar.

**Pozitivja.** Sigmund Freud është i njohur për zhvillimin e një numri terapistësh për kurimin e sëmundjeve psikike, njëra prej të cilave quhet “Klown Terapi”. Ajo i zgjidh problemet me natyrë psikike, duke i vënë pacientët në ambiente gazmore. Sekretarja e programon një pacient pas 4 muajsh, por pacienti këmbëngul sërish dhe kërkon të flasë me Freudin personalisht. Ky, më në fund e pret dhe i sugjeron të shkojë të shohë një kloun të famshëm, të quajtur Creug, në Cirkun që ka ardhur në qytetin e tyre. “Po të shkoni shpesh ta shihni atë, ka mundësi që të shëroheni, ndërkohë që prisni takimin me mua”, - i tha psikanalisti i madh pacientit. “Por unë jam klowni Creug, për të cilin po më flisni”, i përgjigjet pacienti. Pra gjithkush, mund të ketë probleme. Është e rëndësishme t'i konsiderosh ato, pa u dëshpëruar, duke i relativizuar dhe duke pozitivuar.

**Noti** është për mua një lloj meditacioni në mjedis ujor që ka pasur aftësinë të më shpëtojë jetën. Noti sikurse shkrimi janë dy aktivitete që më ndihmojnë të vendos ekuilibrin e duhur për të punuar me efikasitet. Nëse nuk mund të notoj, vrapoj, por nëse mundem, gjithmonë kam preferencë notin. Do të hiqja dorë nga shumë gjëra që më japin kënaqësi, por kurrë nga leximi dhe nga noti.

**Diktatura.** Deri sa thellë i fut diktatura kthetrat e saj, në një individ? Elementi femër me ka ndihmuar që ta tregoj, më me lehtësi se sa me një personazh mashkull, se cilat ishin hapësirat që kishte pushtuar diktatura shqiptare. Tek romani “Pëshpërimë Gruaje”, personazhi kryesor dashuron një individ të klasës tjetër, të quajtur atëkohë “ e përmbysur” dhe dëshiron të mbajë frytin e dashurisë. Por kjo ishte e pamundur në totalitarizmin shqiptar, që e kishte skllavëruar individin. Vajzën e detyrojnë të abortojë, duke vërtetuar kështu që individit, jo vetëm që nuk ishte më pronar i asgjëje materiale, ma që shteti i kishte shpronësuar njerëzit, por tanimë – siç e tregon rasti i Almës, individit nuk ishte më as pronar i trupit të tij.

**Vetvetja.** Të jesh vetvetja në çdo situatë. Këndvështrimi im personal, është shpesh i ndryshëm nga mendimi i shumicës. Kjo është një cilësi e lidhur jo vetëm me një evolucion individual të të menduarit, që vjen nga një analizë e ndryshme nga të tjerët, por ka të bëjë shumë me integritetin. Por që të jesh vetvetja do të thotë që jo vetëm të kesh këtë kapacitet të të menduarit dhe analize, por të kesh edhe kurajën e duhur civile që ta mbrosh këtë mendim edhe kur kjo shkon ndesh shumicës shpesh konformiste, apo të fuqishmëve, të cilëve për një arsye apo për një tjetër mendojnë ndryshe.